



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
**Izborni Panel za Žalbe i Predstavke**

**Anr.500/2019**

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Adnan Konushevcu kryesues, Zyhdi Haziri dhe Ferki Xhaferi anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtares së lartë ligjore Valbona Millaku Foniqi, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me seli në Prishtinë, për shkak të parregullsive gjatë rinumërimit të fletëvotimeve në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, të mbajtura më 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur me 24.11.2019, mori këtë:

## **V E N D I M**

**HUDHET** e pasafatshme ankesa Anr.500/2019 e datës 22.11.2019, e paraqitur nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) - Qendra e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), me të cilën ka kërkuar që dy fletëvotime në Vendvotimin 1914E/01R, të shpallen të pavlefshme dhe të obligohet KQZ - QNR, që këto fletëvotime ti largoj nga votat e vlefshme të publikuar me rezultatin përfundimtar të datës 07.11.2019.

## **A r s y e t i m**

PZAP-i, me datë 22.11.2019, ka pranuar një ankesë Anr.500/2019 nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), në të cilën pretendohet se më datë 21.11.2019, rreth orës 18:00, në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), aktivistet e LVV-së, kanë vërejtur se në kutinë e vendvotimit 1914E/01R, janë shpallur dy fletëvotime të vlefshme në kundërshtim me nenin 7 të rregullës Zgjedhore 06/2013, ku në njërin fletëvotim në të cilën gjendet fletëvotimi i kontestuar është shënuar shenja “tik”, në katrorin e subjektit politik “Nisma”, mirëpo me poshtë në mes numrit 129-130, ku janë të shënuara emrat dy subjekte politike, është shënuar një “vizë-shënjim” e cila tejkalon shiritin nga numri 129 deri në numrin 130, ndërsa në fletëvotimin tjetër i kontestuar nuk është shënuar shenja “tik”, në katrorin e subjektit politik “Nisma”, mirëpo jashtë katrorit të këtij subjekti politik janë shënuar disa shkronja dhe numra të cilët e bëjnë këtë fletëvotim të pavlefshëm. Më tutje paraqitësi në ankesë thekson se shenjat që janë vendosur në dy fletëvotime e bëjnë të pavlefshëm votën e qytetarit përkatës, dhe kërkon që të urdhërohet

KQZ, që të shpallë të pavlefshëm fletëvotimin e gjetur në kutinë 1914E/01R, dhe të njëjtën të mos përfshijë në rezultatin përfundimtar zgjedhor të shpallur me 07.11.2019. Paraqitesi i ankesës ka bashkangjitur ankesës si provë dy fletëvotime.

Në përgjigjen e KQZ-së, të datës 22.11.2019, theksohet se vendvotimi 1914E/01R, është rinumëruar me datën 19.11.2019.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi afatshmërinë e ankesave, gjeti se:

### **Ankesa është e pasafatshme**

Paneli pas shqyrtimit paraprak të ankesës, ka gjetur se ankesa e parashtruar nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), është paraqitur pas afatit ligjor, ngase për të gjitha parregullsitë që mund të paraqiten në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), siç konstatohet nga tabela që është krijuar në QNR, me rastin e numërimit të vendvotimit që është objekt lëndor nga e cila del se ky vendvotim është rinumëruar me datë 19.11.2019 dhe i cili ka filluar të rinumërohet në ora 08:15 dhe ka përfunduar në ora 13:55, sepse ankesat për administrim në QNR mund të paraqiten në PZAP, brenda afatit prej 24 orëve nga ndodhja e shkeljes së supozuar. Në rastin konkret shihet se shkelja e supozuar ka ndodhur me datën 19.11.2019, ndërsa ankesa është paraqitur në PZAP me datë 22.11.2019, që do të thotë pas afatit të paraparë ligjor të përcaktuar me nenin 105 par.1 të LZP-së.

Duke u nisur nga arsyet e theksuara më lart e në kuptim të nenit 118 dhe 119 të LZP-së dhe nenin 6 par.4 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, Nr.02/2015, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Andaj, Paneli në kuptim të nenit 117, 118 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**  
**Anr.500/2019 më datën 24.11.2019**



***Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.***